



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta / Ministry of Culture, Youth and Sports**

---

## **Ftesë për aplikim për Pavijonin Kosovar të Bienales së Artit në Venecia, 2024**

*Ekspozita e 60 – të Ndërkombëtare e Artit në Bienalen e Venecias për vitin 2024*

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall ftesë publike për artistë dhe kuratorë për përfaqësim të Republikës së Kosovës në Edicionin e 60-të të Bienales së Artit në Venecia, që do të hapet për publikun më 20 prill, 2024.

Kurator për Edicionin e 60-të do të jetë Adriano Pedrosa, i cili ka prezantuar temën me titull: **“Foreigners Everywhere (Të Huaj Kudo)”**. Titulli është marrë nga një seri e punëve të nisura në vitin 2004 nga kolektivi Claire Fontaine, të lindur në Paris dhe me bazë në Palermo. Punët përbëhen nga skulptura neoni me ngjyra të ndryshme që përkthejnë në një numër gjithnjë e më të madh gjuhësh fjalët "Të Huaj Kudo". Nga ana tjetër, fraza vjen po ashtu nga nga emri i një kolektivi nga qyteti i Torinos që luftoi racizmin dhe ksenofobinë në Itali në fillim të viteve 2000: *Stranieri Ovunque*. Klikoni [këtu](#) për të lexuar më shumë rreth konceptit kuratorial.

Thirrja është e hapur për projekt propozim të përbashkët artist-kurator, për realizimin e një ose me shumë veprave të reja artistike me qëllim të prezantimit sa më dinjitoz të pavijonit zyrtar të Republikës së Kosovës.

### **1. Kriteret e përgjithshme për artistët:**

- 1.1. Të jenë shtetas kosovarë apo të huaj;
- 1.2. Të kenë dinamikë të aktivitetit artistik- përparësi;
- 1.3. Të kenë paraqitje të njohur ndërkombëtare – përparësi;
- 1.4. Të kenë çmime të fituara ndërkombëtare – e dëshirueshme.

### **2. Detyrat e përgjithshme për artistët:**

- 2.1. Të zhvillojnë koncept original të veprës për prezantim në Bienale;
- 2.2. Të përcaktojnë mediumet (video, skulpturë, instalacion ose tjetër) që do të përdoren për realizimin e ekspozitës;
- 2.3. Të menaxhojnë katalogun zyrtar të pavijonit të RKS-së deri në botim;

- 2.4. Të hartojnë planin e programit kulturor të pavijonit, në koordinim me përfaqësues të MKRS-së;
- 2.5. Të menaxhojnë ekspozitën deri në prezantim dhe pas hapjes së pavijonit;
- 2.6. Të mbajnë kontakt të vazhdueshëm me përfaqësues të autorizuar të MKRS - së;
- 2.7. Të mbajnë kontakt të vazhdueshëm me stafin e Bienales së Venecias rreth organizimit dhe përmbushjes së kërkesave logjistike për realizimin e ekspozitës;
- 2.8. Të angazhohen në ngritjen e kapaciteteve financiare nga burimet tjera;
- 2.9. Të prezantojnë denjësisht pavijonin e RKS-së.

### **3. Kriteret për kuratorë:**

- 3.1. Të jenë shtetas kosovarë apo të huaj;
- 3.2. Të jenë të informuar me skenën e artit pamor në Kosovë si dhe prezantimin e artit bashkëkohor në Kosovë;
- 3.3. Të kenë profil të njohur ndërkombëtar;
- 3.4. Të dëshmojnë se posedojnë shkathhtësi në kurimin e ekspozitave të ndryshme bashkëkohore të artit.

### **4. Detyrat për kuratorë:**

- 4.1. Të zhvillojnë konceptin kuratorial për pavijonin e RKS-së;
- 4.2. Të hartojnë planin e programit kulturor të pavijonit së bashku me artistin, në koordinim me përfaqësues të MKRS-së;
- 4.3. Të përcaktojnë mediumet në bashkëpunim me artistin (video art, instalacion ose tjetër) që do të përdoren për realizimin e ekspozitës;
- 4.4. Të menaxhojnë bashkë me artistin katalogun zyrtar të pavijonit të RKS-së deri në botim;
- 4.5. Të bashkëpunojnë ngushtë me artistin deri në prezantimin e ekspozitës dhe pas hapjes së pavijonit të RKS-së;
- 4.6. Të promovojnë dhe ngrenë kapacitetin e vijueshmërisë së pavijonit me anë të publikimeve dhe ngjarjeve të organizuara.
- 4.7. Të bashkëpunojnë ngushtë me përfaqësues të PR për koordinimin dhe prezantimin e ekspozitës para dhe pas hapjes së pavijonit të RKS-së;

### **5. Përmbajtja e dosjes për aplikim:**

- 5.1. Dokumentet e identifikimit personal dhe të llogarisë bankare;
- 5.2. CV-ja e kuratorëve
- 5.3. CV-ja dhe portfolio e artistëve;
- 5.4. Letra motivuese (500-700 fjalë);
- 5.5. Formulari i kandidimit (shkarko formularin bashkangjitur);
  - 5.4.1 PDF File i aplikacionit duhet të jetë më i vogël se 25 MB, ose mund të dërgoni një Google Drive link apo Wetransfer link.
- 5.6. Prezentimi vizuel i veprave duke përfshirë skicë apo model 3D (Opsionale)

- 5.7. Të gjitha dosjet e aplikimit duhet të jenë të punuara në përputhje me rregulloret e Edicionit të 60-të të Artit në Bienalen e Venecias dhe udhëzimeve të përcaktuara nga kuratori i përgjithshëm i Bienales që mund t'i gjeni [këtu](#).
- 5.8. Dëshmia që nuk janë në hetime.

## **6. Vlerësimi i aplikacioneve:**

- 6.1. Aplikacionet do të shqyrtohen nga juria 5-anëtarëshe.
- 6.2. Vlerësimet bazohen në kriteret si më poshtë:
  - 6.2.1. Origjinaliteti i projekt-propozimit (25 pikë);
  - 6.2.2. Qartësia e prezantimit të konceptit të paraqitur (25 pikë);
  - 6.2.3. Niveli i komunikimit kuratorial me publikun (20 pikë);
  - 6.2.4. Shkalla e përputhshmërisë me temën e Edicionit të 60-të të Bienales (15 pikë);
  - 6.2.5. Kapaciteti për zhvillimin e audiencave të reja (15 pikë).

## **Gjuhët dhe dorëzimi i aplikimeve:**

1. Aplikimi duhet të jetë i përgatitur në dy gjuhë: shqip dhe anglisht, ose serbisht dhe anglisht.
2. Dorëzimi i dosjeve në formë fizike bëhet në Njësinë e Arkivit dhe Protokolimit të Dokumenteve në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
3. Dorëzimi bëhet përmes postës në zyrat e MKRS-së (adresa: Bulevardi Nënë Tereza, nr 35, Prishtinë 10000,) dhe në formë elektronike në adresën [hana.halilaj@rks-gov.net](mailto:hana.halilaj@rks-gov.net).

Për çdo informatë shtesë dhe pyetje mund të shkruani në adresën [hana.halilaj@rks-gov.net](mailto:hana.halilaj@rks-gov.net).

**Afati për aplikim është 6 javë nga data e publikimit.**

*Data e publikimit të thirrjes: 20.07.2023*

*Data e fundit për dorëzimin e aplikimit: 01.09.2023*